

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË RADIOTELEVIZIONIT SHQIPTAR PËR VITIN 2023

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin e RTSH-së në drejtim të përmbushjes së misionit të tij, realizimit të shërbimeve cilësore të radios dhe televizionit për të informuar, edukuar dhe argëtuar publikun, duke i shërbyer kombit, të gjitha grupeve të shoqërisë, përfshirë edhe pakicat kombëtare;

Duke njohur përpjekjet e RTSH-së për realizimin e programeve cilësore, ofrimin e një game të gjerë projektesh në interes të grupeve të ndryshme sociale, rritjen e audiencës dhe shtrirjen sa më të madhe në vend;

Duke konsideruar se veprimtaria e RTSH-së është kryer në përputhje të plotë me detyrimin për të pasur nga ana e saj një mbulim të paanshëm dhe të balancuar të lajmeve të vendit dhe atyre ndërkombëtare, duke bërë të mundur rritjen e besimit të publikut;

Vlerëson veprimtarinë e Radiotelevizionit Shqiptar gjatë vitit 2023 në drejtim të:

Rikonceptimit të imazhit të RTSH-së në funksion të rritjes së konkurrencës përballë medieve audiovizive private sipas fashave orare dhe nevojave të audiencës për më shumë informim, argëtim dhe edukim.

Hapjes së zyrës së përbashkët mes RTSH-së dhe Radiotelevizionit të Kosovës, ku të dyja palët angazhohen që të shkëmbejnë produkte audiovizive në interes të audiencës në Shqipëri dhe Kosovë.

Rikonstruksionit të plotë dhe modernizimit të sallës së Orkestrës Simfonike të RTSH-së, duke mundësuar regjistrimin audio të koncerteve, kalendarit e repertorit të saj artistik dhe realizimin e transmetimeve direkt apo regjistrime televizive.

Rikonstruksionit total të studiove kryesore të Radio Tiranës, duke i hapur rrugën projektit të vizualizimit të të gjitha programeve radiofonike.

Prodhimit të programeve argëtuese, kulturore e edukative për fëmijët.

Kuvendi kërkon që Radiotelevizioni Shqiptar për vitin 2024 të angazhohet edhe në këto drejtime:

1. Të publikojë në faqe shpenzimet e festivaleve, si dhe shpenzimet për prodhimet e pavarura audiovizive, në funksion të transparencës për përdorimin e fondeve publike.

2. Të informojë sa më parë Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik në lidhje me arsyet e numrit të lartë të largimeve nga puna, numrin e rasteve që i janë drejtuar gjykatës dhe efektet financiare që kanë për institucionin këto largime.

3. RTSH-ja t'u dedikojë një pjesë të fondit të prodhimeve të pavarura emisioneve për fëmijë e të rinj, me fokus të veçantë informimin dhe edukimin për fenomenin e bullizmit në këto grup-mosha.

4. Të bëhet transparente veprimtaria e KDRTSH-së në faqen zyrtare *web* duke publikuar të gjitha vendimet e marra, të shoqëruara me relacionet përkatëse, procesverbalet e mbledhjeve dhe mënyrën e votimit.

5. Të bëhet transparente përbërja dhe veprimtaria e Bordit të Administrimit, duke publikuar aktivitetin e këtij bordi dhe të gjitha vendimet e marra dhe aktet e miratuara.

6. Të bëhet transparente përbërja dhe veprimtaria e Këshillit për shikuesit dhe dëgjuesit, si dhe të publikohen të gjitha vendimet e tij.

7. Të angazhohet në realizimin e më shumë emisioneve, programeve argëtuese, kulturore e edukative, prodhime të RTSH-së për të rinjtë, konkretisht për grup-moshat 10–14 vjeç, si dhe 15–18 vjeç.

8. Të angazhohet për transmetimin e programeve edukative, të parashikuara në dispozitat e ligjeve specifike për mbrojtjen e shëndetit, siç është edhe ligji nr. 76/2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9636, datë 6.11.2006, “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, i ndryshuar.

9. Në “RTSH Kuvend” të përfshihen edhe përmbajtje informuese dhe shpjeguese të realizuara përmes bisedave, intervistave apo analizave profesionale me ekspertë të fushës për projektligje që janë në proces diskutimi, në funksion të konsultimit publik për aktet ligjore.

10. Në kuadër të transparencës, të publikohet në faqen zyrtare struktura organizative dhe organika e RTSH-së, të shpallen vakancat e krijuara dhe të jetë transparente e gjithë procedura e rekrutimit deri në publikimin e fituesit.

11. KDRTSH-ja të investohet në hartimin e planit strategjik të institucionit për të siguruar qëndrueshmëri dhe vizion në drejtimin e transmetuesit publik.

12. Të angazhohet në digjitalizimin e arkivit të institucionit.

13. Të investojë në pajisjen me teknologji ndihmëse, me qëllim realizimin e programeve për personat me aftësi të kufizuara.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar në datën 26.7.2024.